

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Luljeta Luboteni, sekretare juridike, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. L. nga P. . i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1828-5/17 të datës 19.09.2017, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, duke vendosur lidhur me kërkësën e Prokurorisë Themelore në Prizren, për dhënjen e urdhërit ndëshkimore, jashtë seancës gjyqësore, me datë 24.10.2017, mëri këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. L., nga i ati Xh. . dhe eëma N. ., e vajzërisë O. ., i lindur me ., në fshtin N. . Komuna e Prizrenit, tani jeton në Prizren, në rrugën “ ”, nr. ., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 18.06.2017, rrëth orës 10.35 minuta, në lagjen D. . nga drejtimi i Prizrenit në drejtim të fshatit L. . duke lëvizur përgjatë rrugës “ ”, i akuzuari duke drejtuar automjetin e markës “VW 19 E”, me targa . . me ngjyrë të bardhë, nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 34, nenin 61 par.1 si dhe nenin 64 të LSKRR-së, kur arrin në vendin kritik, duke mos respektuar shenjat e komunikacionit si dhe duke mos ushtruar kujdesin e duhur, nuk ndalet tek shenjat e trafikut që tregojnë kryqëzimin, e kur hyn në udhëkryq e vëren veturën “VW Touran”, me targa . ., me ngjyrë të zezë, frenon por me vonesë, e me pjesën e parme e godet dhyllën elektrike ndriçuese në mes të rrugës dhe ndalet në trotuar, ku përvèç dëmeve materiale lëndime të lehta trupore, pësojnë të dëmtuarit: B. C. ., B. M. . dhe N. C. ., lëndime këto të pëershruara më përafërsisht si në akt-ekspertimin mjeko ligjor të ekspertit Dr. Valon Hyseni me nr. të ref.23/17 të dt. 23.08.2017.

Kësot dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së.

Prandaj gjykata me aplikimin e dispozitave të nenit të lartëshënuar dhe neneve 4, 41, 43, paragrafi 1 pika 1.3, nenit 46, 73, dhe nenit 495 të KPP-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1828-5/17 të datës 19.09.2017, ashtu që:

Të akuzuari F. L. i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqindë), të cilin dënim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënim i shqiptuar me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi duke llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu, përkatsisht 10 (dhjetë) ditë burgim.

Të dëmtuarit: B (L) C dhe N : C që të dy nga Prizreni Lagja
 , rr. , nr. , dhe B (N) M , nga Prizreni rr.
 , nr. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari F... L... obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën mjekoligjore shumën prej 50 euro, për ekspertizën e komunikacionit 40.88 euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfujishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

Ars vetim

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1828-5/17 të datës 19.09.2017, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrin 1 të KP-së dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetim se janë siguruar të dhënat e besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe janë plotësuar kushtet ligjore konform nenit 493 të KPP-së, për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të kërkesës së PTH-së në Prizren, për dhënien e urdhërit ndëshkimor konstatoi se ka të dhëna të mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhërit ndëshkimor dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykit.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: raportet mjekësore të Spitalit Rajonal në Prizren, me numër rendor të protokolit 6230, 6231 dhe 6232 të dt.18.06.2017, mendimi i ekspertit mjeko ligjor Dr.V. H. i dt.23.08.2017, përkitazi me natyrën, karakterin dhe shkallën e lëndimeve që kan pësuar të dëmtuarit B C B M. dhe N. C., mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor ing.M. D. të dt.13.09.2017, përkitazi me lëshimet dhe parregullsit teknike gjatë drejtimit të automjetit nga ana e të akuzuarit, fotodokumentacioni si dhe nga shkresat tjera të lëndës, vërtetohet se i akuzuarit F. L. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Vendimi mbi kërkesës pasurore juridike është marrë në kuptim të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u muarr në kuptim të nenit 450 dhe 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Më sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1794/2017, me datë 24.10.2017

**Sekretarja juridike
Lulieta Luboteni**

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani
S. Selmani



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit, në këtë gjykatë. Poqëse i pandehuri nuk ushton kundërshtim, "poqëse i përgjigjet".